L I G J
Nr.7967, datë 20.7.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7810, DATË 6.4.1994 "PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Komisionit të Arsimit, Shkencës, Çështjeve Sociale dhe Shërbimeve Publike,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto ndryshime:

Në nenin 7, mbas rreshtit të nëntë shtohet fjalia:

"Zëvendësrektori emërohet nga Ministri i Arsimit mbi bazën e kandidaturave të propozuara nga senati".

Në nenin 7, në rreshtin e katërmbëdhjetë, para togfjalëshit "... në Këshillin e Fakultetit", shtohet togfjalëshi: "si dhe përfaqësuesit e departamentit".

Në nenin 11, pas pikës 2, shtohen edhe pikat:

"11.3. Kursi i studimit është një fushë apo drejtim studimi në shkollën e lartë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë ose çertifikatë nga fakulteti pranë të cilit kryhen me sukses studimet. Sipas natyrës akademike, kursi i studimit mund të emërtohet "degë" apo "profil". Profili është nëndegëzim, rrjedhimisht është një orientim studimi më i ngushtë dhe më specifik se ai që përfaqëson dega.

11.4. Kurset e studimit (degët dhe profilet) hapen në shkollat universitare dhe jouniversitare me vendim të ministrit të Arsimit, mbi bazën e propozimit të senatit të shkollës së lartë përkatëse.

11.5 Diplomat dhe çertifikatat që japin (akordojnë) shkollat e larta për kurset e studimit (degët dhe profilet) njihen nga Shteti Shqiptar kur deklarohen me vendim të ministrit të Arsimit".

Paragrafi i parë dhe i dytë i pikës 1 të nenit 20 ndryshohet si vijon:

"Rektorët, zëvendësrektorët, dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve duhet të kenë emërtesën profesor ose asistentprofesor, por në asnjë rast më të ulët se doktor i shkencave".

Në nenin 20, pas pikës 2, shtohen edhe pikat:

"20.3 Kur në një shkollë të lartë procedurat e zgjedhjeve nuk mund të zhvillohen normalisht për shkak të numrit të pamjaftueshëm të profesoratit, duke përfshirë edhe emërtesën "Doktor", autoritetet drejtuese emërohen duke zgjedhur kandidatë të përshtatshëm edhe nga shkollat e tjera të larta.

20.4 Për shkollat e larta që krijohen të reja, duke përfshirë edhe departamentet, organet kolegjiale (senati, këshilli i fakultetit, këshilli i departamentit) ndërtohen gradualisht gjatë procesit të krijimit dhe plotësimit të profesoratit. Shkolla e re, brenda një periudhe 6-vjeçare nga data e hapjes, duhet të krijojë ose të sigurojë profesoratin e mjaftueshëm për të fituar kredibilitetin akademik dhe për të realizuar procedurat normale të zgjedhjeve të organeve kolegjiale dhe të autoriteteve drejtuese; në rast të kundërt shkolla e lartë konsiderohet pa kredibilitetin e mjaftueshëm për të funksionuar si shkollë e pavarur dhe me vendim të Këshillit të Ministrave i atashohet si shkollë filiale, me vartësi akademike dhe administrative, një universiteti me kredibilitet të lartë".

Paragrafi 3 i nenit 34 ndryshon si vijon:

"3. Për çdo fushë apo kurs të ri studimi që hapet pranë një shkolle të lartë, koha e rregullt e studimeve miratohet nga Ministria e Arsimit mbi bazën e propozimit të senatit të shkollës së lartë përkatëse".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1164, datë 31.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha